

SERIA E BOTIMEVE ELITE

# Diaspora Shqiptare

HARTFORD,  
CT\_Intervista  
2003

**Bashkëbisedim  
i hapur me lexuesit  
shqiptarë për jetën në  
mërgim.**

Kronika e mërgimit të shqiptarëve gjatë shekujve, fillimisht nëpër vende të ndryshme euroaziatike, dhe, më pasë, në Amerikë, Kanada, Australi, Argjentinë, etj. është shumë e gjërë dhe e komplikuar, prandaj ajo mund t'i bëhet e njohur lexuesit shqiptarë vetëm nëpërmjet botimeve seriale enciklopedike.

Në të gjitha kohërat është folur për Diasporën Shqiptare, por

fatkeqësisht ky emër i bukur e kuptimplotë ka mbetur kurdoherë vetëm një slogan, që është përdorur vazhdimisht nga qeveritarët e politikanët shqiptarë të të gjitha ngjyrave për qëllime propagandistike në situata të caktuara kalimtare historike. E themi këtë për arsye se, ndonëse flitet vazhdimisht për Diasporën Shqiptare, e cila, pa asnjë dyshim, ka luajtur një rol të veçantë për emancipimin e Shoqërisë Shqiptare, në të vërtetë ajo nuk njihet sa dhe si duhet, pasi deri tani nuk ka botime përgjithësuëse të mirëfillta, ku të tregohet me fakte e statistika zyrtare, se sa shqiptarë ka në këtë apo atë vend, cilat kanë qenë ngulimet e para, historia e themelimit të kolonive më të vjetra dhe evolimi i tyre deri në ditët e sotme, pozita shoqërore, personalitetet që kanë dalë nga gjiri i tyre, dhe, jo vetëm ato politike e letrare, por edhe biznesmenë të mirënjohur, si, fjala vjenë, shumë i nderuari Anthony Athanas në Boston, Massachusetts, jeta dhe vepra e të cilit është një shëmbull i shkëlqyer frymëzimi e inkurajimi për brezat e sotëm, por pse jo edhe për ata që do të vijnë.

Kanë qenë pikërisht këto ide dhe mendime që na kanë shtyrë t'i futemi punës për botimin e ciklit: **"SERIA E BOTIMEVE ELITE: DIASPORA SHQIPTARE"**, gjë për të cilën jemi të ndërgjegjshëm se kemi marrë përsipër një barrë tepër të rëndë, që, për momentin,

është pothuajse e papërballueshme. Megjithatë, ajo që na bën optimist e të guximshëm ka të bëjë me faktin se, së pari, jemi të bindur se kemi marrë një vendim të drejtë që nuk mund e nuk duhet shtyrë më në kohë; dhe, së dyti, se për realizimin e kësaj inisiative, në mos sot, nesër, do të kemi mbështetjen e të gjithë bashkëatdhetarëve si dhe të mjaftë krijuesve e kolegëve tanë, që ndajnë me ne të njejtat mendime e aspirata për Diasporën Shqiptare.

Projekti **“SERIA E BOTIMEVE ELITE - DIASPORA SHQIPTARE”**, i ideuar dhe prezantuar nga Shtëpia Botuese Elite qysh në vitin 1998, synon që, në fazën e parë: **(1) të bëhet historia e Kolonive më të vjetra Shqiptare në SHBA**, dhe, në të njejtën kohë, **(2) të dëshmohet se si Diaspora Shqiptare, historikisht, që nga vitet 1890’ dhe deri në ditët e sotme, ka ndikuar në forma e mënyra të ndryshme për emancipimin dhe zhvillimin e Shoqërisë Shqiptare.**

Kanë kaluar tashmë më tepër se gjashtë vjet nga dita kur u ideua ky Projekt, dhe, tashmë mund të themi se, Libri i Parë, **“KOMUNITETI SHQIPTARO-AMERIKAN NE KONEKTIKAT”**, që do të hap këtë seri botimesh, është **pothuajse i përfunduar**, pra, gati për të shkruar në shtyp.

**Libri ka rreth 600 faqe, është përgatitur në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht, ka rreth 502 ilustrime me ngjyra: 409 foto; 64 piktura dhe vepra të tjera arti; 16 tabela informative; 13 fotomontazhe, 80 e ca intervista me personalitete e individë të veçantë nga Diaspora Shqiptare, reklama të ndryshme apo ilustrime të tjera me ngjyra.**

Sikurse vihet re, gjatë punës tonë kërkimore në Bridgeport, Hartford dhe Waterbury, ku janë vendosur qysh në vitet 1890’ e më pas tre ngulime nga më të vjetrat me mërgimtarë shqiptarë, kemi përdoruar të gjitha mënyrat e mundshme për hulumtime. Megjithatë, për ta paraqitur realisht gjendjen në ditët e sotme, sidomos në qytete si Hartford-i, ku vetëm gjatë viteve të fundit janë vendosur më tepër se 1500 familje shqiptare, mënyra më e mirë për të komunikuar me lexuesit shqiptarë, është bashkëbisedimi i hapur nëpërmjet intervistave me synime të caktuara, bisedat e shkurtra, komentet dhe opinionet e individëve të veçantë për jetën në mërgim.

Kjo është një punë që, gjithsecili mund ta bëjë fare lehtë nëse dëshiron, dhe, nëse vendos të marrë në dorë një laps dhe një copë letër të bardhë, ashtu sikurse vepron kur ulet për t’u shkruar njerëzve të tij të dashur, shokut

apo mikut, që ka lënë në Shqipëri. Çfarë duhet shkruar konkretisht? Edhe për këtë nuk duhet vrarë mendja aq shumë, pasi këtu më poshtë kemi radhitur 24 pyetje orientuese, të cilave mund t'u përgjigjeni ashtu sikurse dëshironi, gjatë dhe duke i marrë sipas radhës, ose, **fare shkurt, sa për të dhënë një opinion ose për të bërë një koment për një problem të caktuar.**

#### INTERVISTA - PYETJE ORIENTUESE:

1. Largimi juaj nga Shqipëria ishte një rastësi, një lëvizje e imponuar nga rrethana të caktuara, apo thjeshtë një dëshirë për të bërë një jetë më të mirë? 2. A e patët të vështirë për të marrë një vendim të tillë, nëse "po" përse? 3. Si e keni ndjerë veten në çastin kur zbritët për herë të parë në tokën amerikane? Çfarë iu bëri më tepër përshtypje? 4. Cilat ishin vështirësitë e ditëve të para: banesa, gjuha, puna? 5. A keni patur vështirësi për të komunikuar në gjuhën angleze? Si e keni zgjidhur këtë problem? 6. A jeni e (i) kënaqur nga puna që bëni: kushtet, pagesa, e përshtatshme ose jo për profesionin apo natyrën tuaj? 7. Arsimimi & kualifikimi: a ka hapësira të nevojshme që të hapin rrugën për të ecur përpara? Si bëhen aplikimet për të vazhduar shkollën e mesme apo të lartë, kushtet dhe karakteri i tyre? 8. A jeni ndier ndonjëherë e (i) diskriminuar për shkak të

kombësisë apo shtetësisë shqiptare? 9. Cilat janë arritjet tuaja më të mira gjatë kohës në emigracion? 10. A jeni e (i) kënaqur me gjithçka që keni arritur? Planet tuaja për të ardhmen? 11. A jeni e (i) kënaqur nga jeta në Amerikë? Nëse përgjigja juaj është "po", përse? Dhe, nëse përgjigja juaj është "jo", përse? Çfarë ju mungon? 12. A keni dëshirë të vizitoni Shqipërinë? Nëse përgjigja juaj është "po", përse? Dhe, nëse përgjigja juaj është "jo", përse? 13. A e keni ndjerë ndonjëherë veten disi fajtor për braktisjen vendlindjes, ku tashmë ndodhen njerëzit tuaj më të dashur, shokët apo miqtë, me të cilët shoqëroheshit çdo ditë dhe kuvendonit për të mirat e të këqijat e shoqërisë shqiptare? 14. A keni dëshirë të riktheheni në Shqipëri? Nëse "po", përse, çfarë ju shtyn të ndërmerri një veprim të tillë? Nëse "jo", përse, a nuk ndjeni dhimbje kur jeni larg vendlindjes tuaj, të ndarë nga njerëzit tuaj më të afërt që ju kanë dashur dhe ju duan aq shumë? 15. Çfarë njerëzish keni lënë në Shqipëri? Si komunikoni me njeri-tjetrin? Çfarë ju shqietëson më shumë: problemet familjare apo problemet që shqetësojnë vendin? 16. A keni plane për tërhequr në SHBA njerëzit tuaj më të afërt? Përse e keni marrë një vendim të tillë? A është kjo thjeshtë dëshira juaj, apo ndodheni nën presionin e tyre? Arsyet? 17. A keni patur ngjarje të rëndësishme në jetën tuaj në

SHBA? Tregoni raste që ju kanë bërë më shumë përshtypje dhe që ju kanë lënë mbresa të veçanta? Diplomime? Fejesa? Martesa? 18. Së fundi, le të bëjmë, si mund të themi, një llogari: a) Çfarë keni fituar ose çfarë shpresoni se do të fitoni në të ardhmen, duke qendruar në SHBA? Tregoni disa gjëra konkrete, të prekshme? b) Çfarë keni humbur ose çfarë mendoni se do të humbisni në të ardhmen, duke qendruar në SHBA? 19. A rrezikohet identiteti kombëtar? Shkurt: a keni dëshirë ta quani veten shqiptar? Çfarë mendon sidomos brezi i ri në lidhje me këtë çështje? A flisni shqip në familje? A kanë dëshirë fëmijët të mësojnë gjuhën shqipe? A ju pëlqejnë manifestimet sipas traditave e zakoneve shqiptare? Sipas mendimit tuaj, si fillon procesi i ftohjes me vendlindjen, ose, sikurse mund të quhet ndryshe, vendi i origjinës, për ata që kanë lindur jashtë Atdheut? Çfarë harrohet në fillim: gjuha, pastaj traditat e zakonet, e kështu me radhë? 20. Çfarë dëshironi t'u thoni bashkëatdhetarëve që aktualisht jetojnë në Shqipëri? A duhet të ndjekin rrugën e emigrimit? 21. Sipas mendimit tuaj, në një botë të civilizuar, a mund të konsiderohet si një gjë normale fenomeni i emigrimit? Nëse "po", përse, çfarë të *mira* i sjellë ai vendit si dhe familjeve e njerëzve tuaj më të afërt? Nëse "jo", përse, çfarë të *këqija* i sjellë ai vendit si dhe familjeve e

njerëzve tuaj më të afërt? 22. Çfarë duhet të bëjë Shteti Shqiptar për të ruajtur lidhjet si dhe për të komunikuar në mënyrë sistematike me Diasporën Shqiptare? 23. A mund dhe a duhet të jap ndihmesën e tij Shteti Shqiptar për integrimin tuaj në Shoqërinë Amerikane? Nëse "po", në ç'drejtime do ta dëshironit ndihmesën e tij, dhe, në ç'formë e me çfarë mjetesh efikase? 24. Nëse dëshironi, mund të jepni opinione edhe për çështje apo probleme që nuk janë prekur në pyetjet e sipërmendura, ashtu sikurse mund të mos jepni përgjigje për ato pyetje që mendoni se nuk keni ndonjë gjë për të thënë, ose, thjeshtë, sepse nuk dëshironi të jeni e (i) angazhuar. Faleminderit.

Materialin e përgatitur mund ta dërgoni në Via E-mail:

[info@elitelibri.com](mailto:info@elitelibri.com);  
[anasi@elitelibri.com](mailto:anasi@elitelibri.com);

ose me postë në adresën:

**Shtëpia Botuese Elite, P. O.  
Box: 8293, Tiranë, Albania.**

PS: Më poshtë kemi radhitur tërë ata persona shumë të nderuar, që na kanë dhënë intervista të vlefshme për botim në kapitullin: **"Bashkëbisedim i hapur me lexuesit shqiptarë për jetën në mërgim"**, si dhe ata që shpresojmë se do të na i dërgojnë së shpejti **mendimet, opinionet**

apo **komentet** e tyre në adresat e sipërmendura.



THANAS LASKA

(Intervista: gati për të shkuar në shtyp)

*E Mërkurrë, 18 Gusht 2001  
Bisedë e lirë e xhvilluar gjatë një  
udhëtimit nga Hartford CT për në  
Boston, Massachusetts, me Z.  
Thanas Laska, biznesmen i  
mirënjohur Shqiptaro-Amerikan.*

**Pyetje:** Kini qënë kurdoherë larg Shqipërisë, larg familjarëve dhe njerëzve tuaj më të dashur. Çfarë mund t'Ë thoni lexuesit në lidhje me gjendjen tuaj shpirtërore? Çfarë ka ndodhur në botën tuaj të brendshme gjatë kësaj periudhe shumëvjeçare?

**Përgjigje:** Kur u largova për herë të parë nga Shqipëria, në vitin 1922, shkova fillimisht në Stamboll, Turqi. Atëhere unë isha këtermbëdhjetë vjeç, dhe, ndarja nga familja, më është dukur një gjë tepër e rëndë. Në ato kohëra të largëta, rrugën e kurbetit e merrnin veçanërisht djemtë e rinj, me qëllim që të siguronim një jetë më të mirë për vetën e tyre, por edhe për të ndihmuar familjet e të afërmit në Shqipëri, pasi sikurse dihet, ekonomia shqiptare, sidomos

në dekadat e para të shekullit të kaluar, ka qënë shumë e prapambetur. Madje, mund të thuhet tepër e mjeruar! Sigurisht, kjo është një gjë që dihet, kështu që unë nuk po them ndonjë gjë të re në këtë rast, por e përmenda këtë fakt sepse fenomeni i emigrimit të shqiptarëve po merr përmasa të paimagjinueshme edhe sot në kohët moderne.

Shkaqet e mërgimit duket sikur janë të njëjta me ato të kohërave të dikurshme, por rrethanat, sipas meje, janë krejt të ndryshme. Të gjithë e dimë dhe duhet ta pranojmë se, Shqipëria e ditëve të sotme nuk mund të krahasohet në asnjë mënyrë me Shqipërinë e atëhershme, kur ne ishim të rinj, dhe u detyruam ta braktisim Mëmëdheun tonë të dashur, pasi familjet tona nuk siguronin dot as bukën e gojës. E, sot, shqiptarët po largohen nga vendlindja e tyre, jo sepse u mungon buka e gojës, por për një jetë më të mirë, më komode e të civilizuar. Dhe, ky nuk është një veprim i gabuar, pasi gjithsecili ka të drejtë të kërkojë të bëjë një jetë më të rehatshme, me një të ardhme më të mirë, si për vete, por edhe për fëmijët tanë, ndaj të cilëve, ne, si prindër, kemi disa detyrime, pasi duhet t'u krijojmë kushte më të mira jetese, dhe, të mos i lemë të vuajnë, apo të mbeten të paarsimuar, me pretekstin se kështu kemi vuajtur e kemi mbetur pa arsim edhe ne prindërit e tyre. Unë jam tani

shtatëdhjetë e tre vjeç, dhe, ndonëse kam qënë kurdoherë i mërguar, Shqipërinë nuk e kam harruar asnjëherë! Nuk po i them këto fjalë për t'u hequr si patriot, por sepse një gjë e tillë është e vërtetë. Madje, më se e vërtetë! Unë, asnjëherë nuk kam qëndruar larg Mëmëdheut tim të dashur. Përkundrazi, në të gjitha kohërat, deri në ditët e sotme, jo vetëm që i kam ndjekur me vëmendje ngjarjet sipër, ka edhe prpbleme, ka edhe vështirësi, por, këto "të këqija", duhet t'i kapërcejmë të gjithë së bashku, duke komunikuar e duke u marrë vesh për rrugëzgjdhjet më të mira, dhe, jo duke i kthyer shpinën njeri-tjetrit! Unë mendoj se, kjo do të ishte jo vetëm në të mirën e politikanëve e të qeveritarëve shqiptarë, por, mbi të gjitha, në të mirën e Shqipërisë.

**Pyetje:** Sikurse e thatë edhe ju pak më parë, fenomeni i emigrimit të shqiptarëve në ditët e sotme, ka marrë përmasa të paimagjinueshme! Çfarë mendoni në lidhje me këtë, a është kjo një gjë e mirë apo e keqe? Apo ndoshta është më mirë të themi se, nuk është as e mirë dhe as e keqe?

**Përgjigje:** Ashtu është mirë të thuhet, sepse nga emigrimi i bëhet mirë edhe vendit, Shqipërisë tonë të dashur, por edhe familjeve dhe të afërmëve të atyre që emigrojnë, goftë këtu në Amerikë, po ashtu edhe nëpër vende të ndryshme të Europës. Në radhë të parë, vetë

personat që emigrojnë, vetëm apo bashkë me familjet e tyre, emancipohen, civilizohen, sepse jetojnë në një botë më të zhvilluar. Ja, kështu sikurse është Amerika, përshembull. Ju e shikoni edhe vetë. Këtu çdo gjë që të zë syri, shkëlqen, të kënaqet shpirti kur ecën me makinën tënde nëpër autostrada të tilla, si kjo që po udhëtojmë neve tani, ndërsa në Shqipëri rrugët janë shumë të këqija. E di që ti do të më thuash se edhe atje janë bërë e po të lodhshme. Këtë gjë e ndiejnë dhe po e provojnë në jetë, sidomos ata që në Shqipëri kanë qenë intelektualë, dhe, tani që kanë ardhur këtu, fjala vjen, në Hartford, janë të detyruar që të bëjnë punë fizike fare të rëndomta, që, ngandonjëherë, jo vetëm të lodhin edhe të rraskapitin, por të thyejnë shpirtërisht, të mërzhitin deri në atë pikë sa njeriu fillon e mendon se ishte njëqind herë më mirë në Shqipëri.

Këto gjera që po ju them, janë krejt të vërteta, dhe, besoj se, edhe juve duhet t'i keni dëgjuar gjatë bisedave që keni bërë me shqiptarët, këtu në Hartford, apo edhe nëpër qytete të tjera. Dua të them se, paraja nuk bëhet kollaj edhe këtu në Amerikë, nëse nuk lodhesh e djersin çdo ditë. Ata që merren me punë të pista, kudo që mund të jenë, në çdo vend të botës, mund të ndjehen "të lumtur" për një farë kohe, ndoshta për disa muaj apo vjet, por gjërat e pista

zbulohen një ditë, dhe, ajo kënaqësi e përkohshme të del pastaj nga hundët, sepse përfundon në burg! Dhe, burgjet, sidomos këtu në Amerikë, janë shumë të rreptë.

Si përfundim do të doja të thosha se, ata shqiptarë që mendojnë se jeta më e mirë duhet ndërtuar në Shqipëri, pra, jo duke marrë rrugën e mërgimit, nuk e kanë keq, përkundrazi, për të qënë tepër i sinqertë, unë do të thosha se e kanë shumë mirë. Unë kam qenë herë pas here në Shqipëri gjatë këtyre viteve të periudhës së tranzicionit, dhe, kam vënë re se, biznesi shqiptar po ecën me shpejtësi tre komponentë, nuk ka asnjë sekret, nuk ka asgjë që s'e dinë të tjerët. Çështja është se sa këmbëngulës janë njerëzit për ta bërë këtë gjë. Pra, për t'iu futur një pune seriozisht dhe për ta çuar atë gjer në fund. Sepse, po të kalosh nga njera degë në tjetrën, domethënë, të lesh një punë dhe të zesh një tjetër, e kështu me radhë, nuk mund të ecësh përpara. Sigurisht, kur njeriu është në një mjedis të ri, krejt të panjohur, sikurse ka ndodhur me të gjithë shqiptarët që kanë ardhur në këto kohët e fundit këtu në Hartford, do të jetë i detyruar që të bëjë çfardolloj pune. Kështu kam vepruar edhe unë kur kam ardhur këtu për herë të parë në vitin 1956, po me kalimin e kohës, pasi e studiova mirë vendin, fillova të hedh vështrimin larg, drejt të

ardhmes time. Pra, fillova të mendoj se cili do të ishte biznesi im në të ardhmen, çfarë do të bëja unë dhe familja ime? E, kështu, arrita në përfundimin se, duhej të bëja ato që kam bërë deri tani, dhe që ca gjëra ua tregova edhe juve.

Investimet unë i kam bërë me shumë kujdes, veçanërisht nëpër disa lokale publike, si Pizza & Restau-rant, Bar & Coffee, këtu në Hartford, por edhe në disa qytete të tjera, si përshebull në Stamford, e gjetkë. Kam investuar gjithashtu edhe në një Service për automjete, ashtu sikurse kam edhe disa apartamente që i jap gjithmonë me qira, dhe, kjo ka bërë që unë të ruaj kurdoherë ekuilibrin në biznesin tim. Gjatë bisedave të ndryshme, ja, kështu të vështirë, pasi mua nuk më vjen mirë të tregoj se si dhe çfarë kam bërë për të ndihmuar shqiptarët që kanë ardhur këtu në Hartford. Megjithatë, me që po ma kërkon një gjë të tillë, do të doja të thosha se, jo vetëm në ditët e sotme, por që kur kam ardhur këtu në Hartford, aty nga viti 1956, jam munduar që t'i ndihmoj të gjithë shqiptarët që vinin në këtë qytet, ndoshta edhe ngaqë më njihnin mua. Shumica, kuptohet, ishin bashkëfshatarë të mi, nga fshatrat e Permetit, por unë, të them të drejtën, nuk jam kursyer dhe kam ndihmuar çdo shqiptar, si ata të Shqipërisë së Jugut, po ashtu edhe ata që vinin nga Shqipëria e Veriut, apo nga Kosova dhe vise të tjera

shqiptare.

Sidoqoftë, në vitet e shkuara, për arsyet që tashmë dihen, të ardhurit nga Shqipëria ishin të pakët, numëroheshin, si i thonë fjalës, me gisht. Kurse, pas vitit 1991, ose gjatë periudhës së tranzicionit, sikurse është bërë zakon të quhet koha pas rënies së Komunizmit, kanë ardhur shumë shqiptarë në Hartford, dhe, shumica kanë marrë me vete edhe familjet e tyre, çka e vështirëson në një farë mënyre jetesën. Gjatë një dekade të vetme, që nga viti 1991 e këndej, në Hartford kanë ardhur dhjetra familje, që mbase mund të bëhen gati 3000 e ca veta. Pa mendoni njëherë, se si dhe ku janë sistemuar tërë këta njerëz, se si dhe ku janë punësuar, pasi pa të ardhura s'kishin se të jetonin, s'kishin se çfarë të hanin, e kështu me radhë. Nuk dua të dhe që, sot do të jemi për drekë tek shumë i respektuari Z. Anthonis Athanas, në lokalitë e tij të mirënjohur "Pier 4" në Boston. Ai na pret me një kënaqësi të veçantë, dhe, bisedën që kemi nisur bashkë, ne do ta vazhdojmë patjetër edhe atje, ndonëse ai duhet të jetë shumë i zënë me punë pasi më datën 27 Gusht 2001, domethënë, ditën e enjte të javës së ardhshme, feston nëntëdhjetvjetorin e lindjes së tij. Kjo është me të vërtetë një ngjarje e shënuar jo vetëm Z. Anthony Athanas, por për të gjithë ne shqiptarët që banojmë në Massachusetts, Connecticut, si dhe

në shtete të tjera Amerikane. Sa për dijeni, kur flasim për Shqipërinë dhe shqiptarët në mërgim, kudo që ndodhen, ne as lodhemi dhe as nuk mërzhitemi. Përkundrazi, na shtohen energjitë dhe zemra na bëhet mal, sikurse thotë një fjalë e urtë popullore. Nuk e mbaj mend mirë, më duket se jua thashë edhe pak më parë, që unë jam tani shatadhjetë e tre vjeç, por në raste të tilla, më duket vetja fare i ri, sepse më gëzon shpirti përbrenda. S'ka gjë më të bukur në botë se të kuvendosh me një mikun tend për Mëmëdheun e dashur. Ndoshta nuk e teproj po të them se, Mëmëdheun e tyre, Shqipërinë, e kanë dashur dhe e duan të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, por ata që e kanë dashur dhe e duan më shumë, kanë qenë dhe janë ata që kanë jetuar ose jetojnë larg tij. E, këtë dhimbje, për Mëmëdheun tonë të dashur, e kemi provuar vetëm ne e tij, e cila vdiq në vitin 1985 në moshën tetëdhjetë e pesë vjeçare.

Kjo mund të quhet, si të thuash, bërthama e parë e Kolonisë Shqiptare të Hartford-it, e cila ka ardhur pastaj duke u rritur, nga viti në vit, por jo me ritme të shpejta, ashtu sikurse mund të flitet për Koloninë e Bridgeport-it, apo Koloninë e Waterbury-it në Connecticut.

**Pyetje:** Tani po i afrohem Bostonit, prandaj unë po shpejtoj të bëj edhe ato pak pyetje që kanë



mbetur këtu në bllokun tim të shënimeve. Çfarë mund t'i thoni lexuesit për regjimin Komunist në Shqipëri? Cili është opinioni Juaj në lidhje me politikat ekonomike që janë ndjekur gjatë kësaj periudhe pesëdhjetëvjeçare? A mund të evidenconni disa nga gabimet më themelore?

**Përgjigje:** Marksist nëpër veprat e tij, të cilat besoj se ju duhet t'i keni lexuar më mirë se unë, e zbulonte shumë Komunizmin, aq sa ngandonjëherë dukej si një ëndërr. Do të ishte me të vërtetë një mrekulli nëse do të arrihej të ndërtohej një shoqëri njerëzore si ajo që përshkruan ai, por mjerisht kjo ishte një punë që nuk mund të bëhej, prandaj edhe vendet që u futën kësaj aventure dështuan, dhe, më në fund, u detyruan të rikthehen në rendin e ekonomisë së tregut të lirë.

Sipas meje, çështja është fare e thjeshtë: nëse goditet prona private, shkatërrohet interesi për të punuar, dhe, kur që të qarkullonin lirisht, të shkonin pranë familjarëve apo të afërmëve të tyre nëpër vende të ndryshme të botës, dhe, anasjelltas. Nëse ndokush nuk dëshironte të rikthehej në Atdhe, kjo nuk i sillte asnjë të keqe Shqipërisë. Madje, në raste të veçanta, sidomos të rinjtë e talentuar, shteti duhej t'i inkurajonte që të shkonin në vende të tjera të zhvilluara, me qëllim që të punonin apo të vazhdonin

shkolla të ndryshme, dhe, mandej, të riktheheshin në Atdhe me një eksperiencë të pasur e përvojë të re. Inisiativa të tilla do ta mbanin kurdoherë gjallë ekonominë shqiptare.

Më kujtohet se, aty nga viti 1963, bashkë me disa miqtë e mi, ishim të ftuar në Shqipëri për të bërë një vizitë miqësore, si atdhetarë, dhe, autoritetet e vendit, na shëtitën gjithandej për të parë përparimet që kishte bërë vendi. E vërteta është se, pamë gjëra që na e kënaqën shpirtin, Shqipëria kishte ecur përpara. Megjithatë, duke u udhëhequr nga qëllime të mira, për ta ngritur ekonominë shqiptare në nivele të reja bashkëkohore, unë i propozova Z. Reis Malile, që të zhvilloheshin bisedime me disa firma të njohura amerikane, të cilat, nga sa isha informuar unë, ishin të gatshme që të bënin investime në Shqipëri, veçanërisht në disa degë jetike të ekonomisë shqiptare. Nëse do të ishte pranuar një gjë e tillë, nga e cila Shqipërisë nuk do t'i kishte ardhur asnjë e keqe, ekonomia shqiptare qysh atëherë do që e duan punën, do të doja t'u thoshja, në radhë të parë, politikanëve, e më pas, qeveritarëve të sotëm, që të merren vesh me njeri- tjetrin dhe të mos e pengojnë vendin që të ecë përpara, për hir të kapriçove e interesave të tyre të ngushta personale.

**Pyetje:** Sikurse po e shikojmë,

udhëtimit tonë po i vjen fundi, pasi po hyjmë në lagjet periferike të Bostonit, të cilin unë po e vizitoj për herë të parë dhe kam shumë dëshirë që ta sodis me vëmendje. Megjithatë, ngaqë gjatë gjithë rrugës në kasetofonin tuaj kemi dëgjuar vetëm muzikë popullore permetare, dua t'u pyes: këto kasete i mbai gjithmonë me vete apo i morët sot me qëllim që të krijoni një atmosferë sa më të gëzueshme?

**Përgjigje:** Unë jam përmetar dhe gjatë gjithë jetës time kam dashur çdo gjë që është përmetare, por mbi të gjitha kam dashur muzikën përmetare, veçanërisht këngët popullore, të kënduara aq bukur nga mjeshtrit e këngës e të muzikës përmetare. Mëmëdheu ynë i dashur, që këndej është shumë larg, por këto këseta që shikoni këtu pranë kasetofonit të makinës time, unë i mbaj vazhdimisht me vete dhe i dëgjoj herë pas here, sepse ato ma afrojnë Shqipërinë dhe e gjallërojnë shpirtin tim jashtë mase. Sa herë që kam ardhur në Shqipëri, kam blerë vazhdimisht kasete me muzikë shqiptare, sidomos me këngë popullore, dhe, jo vetëm përmetare, por nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, sepse vendi ynë është një edhe i pandarë. Kam blerë gjithashtu edhe mjaft videokasete me filma artistikë shqiptarë. Ndoshta mund t'u duket si çudi, por në arkivin e familjes time ndodhen më shumë

se njëqind e pesëdhjetë videokasete me filma artistik shqiptarë. Pra, sikurse po e vini re, ndonëse jetojmë këtu në Amerikë, ushqimin tonë shpirtëror e kemi sjellë vazhdimisht nga Shqipëria jonë e dashur, të cilën e kemi patur dhe do ta kemi kurdoherë në Mendje e në Zemër.

Kjo bisedë e lirë u zhvillua nga: Apostol Nasi, Shkrimtar & Botues



**JORGO NAKO** (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



**ALI AGO** (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



**ELENI NIKOLLA** (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ERIONI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ALDA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



SANDRI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ROLANDI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



DONIKA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ORNELA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ELONA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



KEJSI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ARTURI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ARTEMISI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



BRUNA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



DENIOINI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ROLANDI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



VALENTINI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



VJOLLCA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



LIRI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



SONILA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



LILIA(Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ERMELINDA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



TRIFONI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



(Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



LILIANA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



JETA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



HYZENI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ZNJ LICI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



STEFANI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ZNJ LICI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



MAKSI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



FLAVIO (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



MIMOZA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ANA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



LIRIA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp, por s'ka foto)



ADRIATIKU & TEUTA  
(Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



NESIMI (Intervista:  
gati për të shkuar në shtyp)



TEUTA (Intervista: shpresoj se  
do të realizohet së shpejti)



ELIDA (Intervista: shpresoj se do  
të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



LADI (Intervista:  
gati për të shkuar në shtyp)



LETA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



LEKOJA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ADA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ONI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



SRAVRI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



EVA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



LIDA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



ARMELA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)





(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



(Intervista: shpresoj  
se do të realizohet së shpejti)



LIRIMI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



DRITANI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



MONDA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



SOKRATI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ANISA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



VANGJELI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



RAIMONDA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ERIONI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ILIA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp, por s'ka foto)



ARBENI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



IKE ZHUTA (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



ANDONI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



DJALI (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



BLEDARI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)



VAJZA (Intervista: shpresoj se do të realizohet së shpejti)



MYFTAR GJINI (Intervista: gati për të shkuar në shtyp)

Shumë të nderuar Miq!

Lutemi, edhe njëherë: Merrni pjesë në rubrikën **“Bashkëbisedim i hapur me lexuesit shqiptarë për jetën në mërgim“**, duke dërguar me shkrim mendimet, opinionet apo komentet Tuaja në adresën e Shtëpisë Botuese Elite Tiranë.

Përsëritje,  
Apostol NASI  
Shkrimtar & Botues